



## KUVENDI I SHQIPËRISË

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

*Nënkomisioni për Qeverisjen Vendore*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.02.2020, ora 10:30

**Drejton mbledhjen:**

**Bashkim Fino - kryetar i Nënkomisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Dëgjuesë me zëvendësministren e Brendshme, zonjën Romina Kuko dhe drejtuesin e Agjencisë për Mbështetje të Vetëqeverisjes Vendore, zotin Bekim Murati, për Strategjinë e Re të Pushtetit Vendor.

#### **Marrin pjesë:**

Bashkim Fino, Korab Lita, Edmond Leka, Edlira Hyseni, Adnor Shameti, Jurgis Çyrbja, Nimet Musaj, Ediola Braha, Aurora Mara dhe Elena Xhina.

#### **Mungojnë:**

Klotilda Bushka dhe Halil Jakimi

#### **Të ftuar:**

Znj. Romina Kuko – Zëvendësministre e Brendshme

Znj. Aida Gjika - Eksperte e Qeverisjes Vendore dhe Decentralizimit

Znj. Romina Kacorri – Asistent Zevendesministri

Z. Bekim Murati – Drejtor i Përgjithshëm

Znj. Adelina Farrici - Kryetare Shoqatës për Autonomi Vendore

Z. Agron Haxhimali – Drejtor ekzekutiv I Shoqatës e Bashkive të Bashkisë

## HAPET MBLEDHJA

**Bashkim Fino** – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e nënkomisionit për qeverisjen vendore. Sot, në vazhdim edhe të mbledhjes që bëmë pardje së bashku me nënkomisionin tjetër të barazisë gjinore, kemi një dëgjesë me zëvendësministren e Brendshme, zonjën Romina Kuko dhe me drejtuesin e Agjencisë së Vetëqeverisjes Vendore, me zotin Bekim Murati, drejtor i përgjithshëm.

Kemi ftuar dy shoqata, Shoqatën për Autonomi Vendore, me përfaqësuese zonjën Adelina Farici dhe Shoqatën e Bashkive, me përfaqësues zotin Agron Haxhimihali.

Mbledhja e sotme konsiston në një dëgjesë që ne do të bëjmë në funksion të vazhdimit të strategjisë së re të decentralizimit të pushtetit vendor.

Unë mendoj të dëgjojmë në fillim zëvendësministren, zonjën Romina Kuko pastaj përfaqësuesit e shoqatave. Në fund ne do të bëjmë disa konkluzione, të cilat do të jenë të vlefshme dhe do të adresohen për qeverinë, por natyrisht edhe për ne, për t'ia paraqitur pastaj edhe Komisionit të Ligjeve apo edhe vendimmarrjeve të tjera që do të ndër marrë qeveria nëpërmjet disa projektakteve të ndryshme që ne duhet të bëjmë për organet e pushtetit vendor.

Ju uroj mirëseardhjen në komisionin tonë!

Ne jemi një komision i thjeshtë, i qetë, jemi profesionistë dhe nuk bëjmë politikë, se organet e pushtetit vendor janë të gjithëve, u shërbejnë të gjithë qytetarëve, prandaj do të mundohemi të jemi sa më koncizë në diskutimet dhe pyetjet tona.

Urdhëroni!

**Romina Kuko** – Faleminderit, zoti Fino!

Mirëmëngjesi të gjithëve!

Në radhë të parë, ju falënderoj për ftesën tuaj për të pasur këtë seancë dëgjimore në Nënkomisionin e Çështjeve Vendore.

Duke qenë se jemi pas një periudhe kur kemi bashki të reja, të cilat kanë nevojë të konsolidohen edhe më tej dhe duke qenë se edhe pushteti vendor gjendet në një moment kritik, si dhe duke qenë se reforma e decentralizimit ka arritur në vitin e pestë të saj, mendojmë të gjithë se është momenti për të diskutuar dhe për të bërë një vlerësim, nëse strategjia e decentralizimit, ligji nr.139, ligji organik, kanë qenë efikasë në tërësinë e tyre, apo ka nevojë për rikalibrimin e tyre.

Unë nuk do të zgjatem shumë me ato çka kemi bërë për të raportuar. Ju e kemi marrë një raport dhe një informacion të plotë gjatë vizitës suaj në Agjencinë për Mbështetjen e

Vetëqeverisjes Vendore. Ajo që unë do të theksoj sot, mendoj se janë katër çështjet, të cilat do të duhet t'i fillojmë sot t'i diskutojmë.

Në radhë të parë është çështja që ka të bëjë me plotësimin e kuadrit ligjor në pjesën e pushtetit vendor. Ligji nr.139/2015, ligji organik, patjetër që solli një ndryshim të madh në mënyrën se si pushteti vendor menaxhohet, si është roli i kryetarit të bashkisë, roli i këshillave, funksionet e deleguara, çështjet e autonomisë fiskale e të tjera.

Në vitin 2019 Ministria e Brendshme bëri një analizë, mbështetur edhe nga donatorët, për të parë se ku janë mungesat aktuale të legjislationit që ka lidhje me pushtetin vendor.

Ju keni përpara matricën e kompetencave, që është një listë e plotë e të gjitha ligjeve, të cilat janë miratuar, e ligjeve të cilat do të duhet të miratohen dhe disa propozime për ndryshime dhe ligje të reja.

Ndërkohë, kemi bërë edhe një analizë financiare për të parë nëse bashkitë kanë pasur burimet e nevojshme për të zbatuar dhe për të implementuar funksionet e reja, në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë qytetarëve.

Pra, tema e parë është nëse do të duhet të kemi një plan, një kalendar, i cili detyron institucionet qendrore për të nxjerrë të gjitha aktet nënligjore apo çdo akt tjetër, që rregullon mirëfunksionimin e pushtetit vendor.

Ministria e Brendshme është institucioni që e koordinon këtë, por ministrinë e tjera janë ato që kanë përgjegjësinë e tyre, sidomos për funksionet e deleguara në pushtetin vendor.

Pika e dytë, që dua të diskutojmë bashkërisht, është çështja e strukturave të bashkive. Ne kemi parë që një pjesë e bashkive të vendit, paçka se gjatë reformës u krijua një model se si ato do të duhej të funksionin, strukturat e tyre, numrin organik që do të duhej të kishin, disa për bashkive kanë një tejfryrje të strukturave të tyre. Ka ndodhur që kryetarët e bashkisë kanë krijuar pozicione në bashki, të cilat kanë marrë energji dhe fonde nga pjesa e investimeve.

Ka ardhur momenti që ne të institucionalizojmë dhe të krijojmë një standard kombëtar për strukturat e bashkive, në mënyrë që një bashki e vogël të ketë një administratë që i përket dhe të mos ketë një administratë të tejfryrë, e cila në fund të ditës kthehet në një administratë jofunksionale.

Pjesa e tretë ka të bëjë me Këshillin Konsultativ, organin konsultues mes qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Në datën 25 do të kemi këshillin e parë konsultativ për vitin 2020, dhe do të ishim të nderuar që komisioni të ishte i pranishëm në punimet e këtij këshilli konsultativ.

Deri tani kemi pasur 16 seanca përgjatë vitit 2018-2019, pra kemi pasur seanca të përmuajshme për konsultimin e ligjeve, megjithatë mendojmë se është momenti që

nënkomisioni të marrë rolin e vet, sidomos në momentin e rakordimit të këtyre ligjeve, kështu që do të duhet të gjejmë një mekanizëm për të kaluar të gjithë praktikën apo konsultimin që ndodh në këshillin konsultativ nëpërmjet komisionit.

Gjithashtu, dua t'ju informoj se kemi bërë një analizë të strategjisë së decentralizimit, një analizë të ndërmjetme dhe kemi dalë në konkluzionin se plani i veprimit i kësaj strategjie do të duhet të pësojë disa ndryshime, të cilat nuk janë ndryshime që ndikojnë mbi shtyllën kurriore të strategjisë, por janë thjesht ndryshime të cilat rregullojnë sidomos aspektet që kanë të bëjnë me çështjen e financave vendore.

Kjo është një temë, e cila duhet të diskutohet në një mbledhje të ardhshme së bashku me Ministrinë e Financave dhe mendoj se takimi i ardhshëm do të duhet të jetë një takim për financat vendore dhe pjesës së shërbimeve në nivel vendor.

Duke u fokusuar te shërbimet dhe duke qenë se bashkitë kanë marrë një rol shumë të rëndësishëm për t'i shërbyer qytetarëve, propozoj që ne të fillojmë me një diskutim lidhur me vendosjen e standardeve kombëtare për mënyrën se si bashkitë ofrojnë shërbimet e tyre. Nuk e di nëse do të duhet të kemi një ligj të posaçëm për këto standarde kombëtare, apo do të duhet të kemi akte nënligjore, por ka ardhur momenti që qytetarët e Shqipërisë të marrin të njëjtin standard si në Shkodër, si në Korçë, si në Përrenjas dhe në çdo bashki tjetër.

Këto janë, pak a shumë, disa nga piketat që unë do të doja të vendosja sot në këtë takim.

Fjalën po ia jap zotit Murati për një rezymë shumë të shkurtër lidhur me punën e agjencisë.

Faleminderit!

**Bashkim Fino** – Fjala për drejtorin.

**Bekim Murati** - Faleminderit!

Agjencia në vizionin e saj dhe në të gjithë angazhimin e saj është e prirur të mbështesë dhe të asistojë në procesin e kësaj reforme, e cila po zhvillohet dhe tani po futemi në vit të pestë.

Sigurisht, agjencia në detyrat e saj funksionale ka mbështetjen dhe koordinimin e veprimtarisë së të gjitha njësive të qeverisjes vendore, por edhe si një intelektual midis dy pushteteve, pushtetit qendror dhe pushtetit vendor.

Në aspektet funksionale të kësaj agjencie dihet se çfarë duhet bërë dhe si do të duhet t'i qasemi procesit të decentralizimit dhe ne kemi ndërmarrë hapat tanë për ta çuar më tej këtë strategji kaq të madhe dhe kaq shumë dimensionale. Sigurisht, duke u fokusuar në çështjet konkrete që po diskutojmë, në ato që tha edhe zëvendësministrja, sigurisht, agjencia merr një

rol për të qenë pranë njësive të qeverisjes vendore dhe për të marrë çfarë atyre u intereson dhe çfarë do të duhet të përmirësojmë në kuadrin ligjor.

Në kuadrin ligjor janë bërë disa hapa të rëndësishëm, kemi prodhuar një dokument, i cili na udhëheq në procesin e vendimmarrjes dhe në procesin e hartimit të legjislacionit. Kemi një përjasje nga disa institucione, por jo nga të gjithë që ky legjislacion të plotësohet. Ministria e Shëndetësisë dhe e Përkrahjes Sociale ka një intensitet më të madh, Ministria e Turizmit po ashtu ka sjellë disa akte, por që të plotësohen të gjitha këto, i gjithë kuadri ligjor i të gjitha institucioneve, të cilat u deleguan me ligjin organik dhe në zbatim të reformës, do të duhet të kemi një qasje shumë më tepër institucionale dhe më të angazhuar nga të gjitha ministrinë.

Ne po përpiqemi maksimalisht, duke bashkëpunuar edhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme, që këto akte të vijnë dhe të paraqiten në qeveri, duke kaluar nëpërmjet Këshillit Konsultativ, i cili është një organ që ka arritur të japë efektin e tij, sigurisht që do të duhet të forcohet më shumë duke ndjekur procedurat dhe mënyrën se si do t'i qasemi zbatimit, jo vetëm hartimit të dokumentacioneve, hartimit të projektakteve, por edhe zbatimit të tyre në nivelin vendor.

Këtu e gjejmë me vend të bëjmë një diskutim për mënyrën se si do t'i qasemi, qoftë Ministria e Brendshme, qoftë agjencia, që të shikojmë zbatueshmërinë e akteve ligjore në pjesën që i takon pushtetit vendor, kjo në funksion të krijimeve standarde kombëtare për shërbimet, të cilat do të duhet t'i japë në nivel vendor.

Kemi një përjasje shumë të mirë nga niveli vendor, në pjesën më të madhe të tyre, falë kësaj, si dhe në bashkëpunimin me projektet. Kemi krijuar 43 njësi të shërbimeve me një ndalesë, ku po tentojmë të kemi sa më shumë shërbime, kjo bazuar edhe në prioritetin dhe në programin e qeverisë shqiptare.

Aktualisht, 43 bashki operojnë me nivelin e zyrave "One stop shop" dhe japin deri në 70 shërbime administrative. Procesi do të duhet të përfundojë edhe në bashkitë e tjera, që të kemi një kuadër të plotë të 61 bashkive që janë në sistem dhe ne mendojmë që mbasi të krijohen dhe pasi të ngrihen këto zyra, do të duhet të ngremë një sistem kombëtar të performancës së këtyre njësive, të cilat do të duhet të fillojnë pastaj procedurën më tej se njësia vendore, pra të shtrihemi deri në njësitë administrative.

Ky është një projekt me të cilin do të duhet të bashkëpunojmë dhe do të duhet të kemi edhe kontributin e Komisionit të Çështjeve Vendore se si do të duhet t'i qasemi, në mënyrë që shërbimet ndaj qytetarit t'i vijnë sa më afër atij, sepse kjo është në thelb edhe një nga objektivat kryesore të strategjisë, por edhe të reformës administrative territoriale.

Agjencia është e angazhuar të plotësojë dhe të koordinojë, bashkë me projektet dhe donatorët, kontributin që do të duhet të japin ata në procesin e integritimit evropian apo edhe në të gjithë proceset e tjera, ku bashkitë kanë rolin e tyre në shërbimet që japin për qytetarët, sigurisht, pa harrur edhe funksionet e tjera që kanë bashkitë, qoftë kjo nëpërmjet këshillit bashkiak, duke krijuar mundësinë që këshillim bashkiak të përfshihet dhe të jetë pjesë e drejtimit dhe orientimit të bashkisë, duke i orientuar dhe duke i vënë në tavolinë disa dokumente shumë të rëndësishme që të funksionojnë siç duhet brenda organit të cilin drejton.

Në punën tonë ka disa sfida, si monitorimi dhe zbatimi i strategjisë së decentralizimit në të gjitha aspektet e tij, por i bashkohem asaj çka zëvendësministrja e Brendshme, në bashkëpunim me agjencinë, po bën për pushtetin lokal.

Ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me kryetarët e bashkive dhe me disa nga ministrinë, të cilat kërkojnë kontributin tonë apo duan bashkëpunim tonë për të çuar më tej reformën e decentralizimit, për të çuar më tej gjithë ato kompetenca dhe ato funksione që niveli vendor ka marrë dhe që do të duhet t'i kuptojë dhe t'i absorbojë.

Zgjidhjet e vitit 2019 krijuan një moment qetësie, një moment shqetësimi në lidhje me ndryshimin e lidershit, sepse ndryshuan 39 kryetarë bashkish dhe do të duhej të kishim qasjen e tyre menaxheriale, por me fillimin e vitit kemi parë që edhe në takimet që kemi zhvilluar, një pjesë e bashkive po vazhdon dhe po ecën me ritme të mira, por duhet të kuptojnë atë çka duhet të bëjnë.

Sfidë mbeten financat, sfida janë një pjesë e borxheve, të cilat nuk janë likuiduar akoma, por e rëndësishme është që ne të gjithë bashkë të kemi mundësi që niveli vendor nëpërmjet ligjit apo nëpërmjet akteve ligjore të krijojë standardet kombëtare të shërbimeve dhe pastaj këto standarde do të fillojmë t'i monitorojmë dhe të shikojmë se si po zbatohen.

Në tërësinë e vet reforma këto 5 vjet i ka arritur qëllimet e saj. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencia e ka plotësuar pjesën ligjore për sa i takon asaj çfarë do të duhet të propozonte dhe të miratonte. Jemi në diskutim dhe kemi përgatitur draftin e fundit si ministri, që ligji "Për policinë bashkiake" dhe shumë shpejt do të hedhim në diskutim me gjithë aktorët, por do ta sjellim për miratim edhe në parlament.

Sigurisht, një nga pjesët dhe një nga punët e agjencisë ka qenë edhe bashkëpunimi me shoqatat dhe shoqërinë civile. Besoj se dy drejtorët ekzekutivë të shoqatave këtu, mund të japin kontributin e tyre. Ata kanë qenë pjesë dhe vazhdojnë të na japin një kontribut të vyer lidhur me çështjet e pushtetit vendor.

Ju faleminderit!

**Bashkim Fino** – Faleminderit!

Unë mendoj të vazhdojmë me dy drejtuesit e shoqatave të bashkive, e pastaj fjala për kolegët tanë. Fjala për zonjën Adelina Farrici. Ndonjë gjë konkrete në lidhje me këto që tha zëvendësministri e drejtori, por edhe problemet e tjera që ju shqetësojnë juve si shoqatë, në mënyrë që ne të marrim përsipër adresimin e problematikës.

**Adelina Farrici** – Përshëndetje të gjithëve,

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht, dua të falënderoj Nënkomisionin për Çështjet Vendore, që e kthen vëmendjen te një diskutim midis pushtetit vendor dhe pushtetit qendror. Dihet se në kushtet aktuale, pushteti vendor është një pushtet i cili ofron pothuajse shumicën e shërbimeve për qytetarët dhe është në komunikim direkt me qytetarët. Ka zgjerim të territorit, pra edhe zgjerim të funksioneve të pushtetit vendor. Të gjitha këto çojnë patjetër në vështirësi dhe në nevojën dhe domosdoshmërinë e koordinimit të të gjithë aktorëve, me qëllim performimin e mirë të punës së pushtetit vendor.

Në fakt, do të fokusohem kryesisht te këto që sapo u thanë, po përpara se të filloj me pikat përkatëse, unë dua të evidentoj bashkëpunimin me vazhdueshëm me shoqatën, si nga ana e të ministrisë, ashtu edhe nga ana e agjencisë. Kemi qenë në vazhdimësi pjesë e grupit të punës. Gjithashtu, dua të theksoj qasjen e tyre pozitive për të mbështetur opinionet e shoqatës e të kryetarëve, por jo gjithmonë ky pozitivitet i agjencisë dhe i ministrisë ka gjetur mbështetje nga pjesa tjetër e qeverisë. Kjo pasi komunikimet dhe draftet ligjore vijnë kryesisht nga ministrinë e linjës përkatëse, në varësi të fushave që trajtohen.

Ajo që ne evidentojmë, është se në këshillin konsultativ, nga të gjitha ato drafte që vijnë, merret shumë pak në konsideratë mendimi i sjellë nga shoqata ose bashkitë. Nëse do të bëhej një statistikë e drafteve të ardhura në këshillin konsultativ dhe e ndryshimeve të pësuara në këto drafte pas opinionit të dhënë nga shoqatat, nuk duhet të jemi të kënaqur.

Pra, mund të evidentojmë se një rast pozitiv është ai i trajtimit të ligjit “Për financat vendore”, kur arritëm të vendosnim një dysheme për 1 % për grantin e pakushtëzuar, që ishte parashikuar 0,8 % - 0,9 % nga ana e ministrisë. Gjëja e mirë ishte se u bë jo më pak se 1 %.

Unë dua të sjell në vëmendjen tuaj që, pavarësisht se ishte më pak se 1 %, kishte tentativa që të ishte më pak se 1 % edhe për buxhetin e 2020-ës, por megjithatë, kjo u rregullua shumë shpejt. Në fakt, dua të them se, mbase në këtë njëpërqindësh është përfshirë edhe transferta, që dikur ishte transferta e kushtëzuar ose transferta për funksionet e deleguara. Domethënë, nëse do të përkthehet në buxhet më të madh për pushtetin vendor, në krahasim me shërbimin që kryen, nuk është një buxhet i mjaftueshëm për pushtetin vendor.

Gjithashtu, do të doja mbështetjen tuaj që, në momentin e transferimit të kompetencave te pushteti vendor, të rishikohen edhe një herë buxhetet. E para: nëse janë transferuar këto kompetenca me buxhete të mjaftueshme për pushtetin vendor. E dyta: a kemi një kuadër ligjor të qartësuar, i cili i ndan mirë kompetencat qendrore e lokale për atë funksion, Nëse do t'i referohemi funksionit për arsimin parashkollor, funksionit për bujqësinë dhe për pyjet?

Kemi probleme me kuadrin ligjor. në fakt, me Ministrinë e Turizmit kemi bashkëpunuar dhe jemi drejt përmirësimit të ligjit “Për pyjet”, sepse në fakt, kompetenca për pyjet është e bashkive, ndërsa inspektoriati është i qeverisjes qendrore. Është nonsens, pasi bashkitë nuk kanë edhe inspektoriatin që t'i kontrollojë, t'i monitorojë dhe të penalizojë. Të gjitha këto resurse të dërguara pushtetit vendor duhet të shikohen si resurse për të sjellë të ardhura për pushtetin vendor, por nëse nuk e ka krejtësisht të plotë kompetencën për atë funksion, dalin probleme në lidhje me eficiencën e plotë nga ana e pushtetit vendor. E njëjta gjë është edhe për arsimin parauniversitar.

Prandaj, mendoj se ky vit përbën një sfidë për të gjithë ne, që të qartësojmë... Pra, mbase katërvjeçari na shërbeu si një eksperiencë për të parë se ku nuk funksionojnë gjërat, por mendoj se ky mandat është një mandat sfide, për të qartësuar pikërisht ato problematika që kanë dalë gjatë katërvjeçarit të parë.

Gjithashtu, unë dua të evidentoj këtu faktin se vazhdojmë akoma të mos kemi zbatimin ligjor në lidhje me kalimin e dypërqindëshit të TAP-it për pushtetin vendor. Nuk e kuptoj, sepse nuk ka kaluar as 2018-a dhe as 2019-a, ndaj ne shpresojmë të kalojë te 2020-a.

Kjo mund të duket gjë e vogël, po për pushtetin vendor është gjë shumë e madhe, sepse përmirëson një shërbim të dhënë nga ana e pushtetit vendor, por edhe zbatim i ligjit, të cilin e miratuar të gjithë së bashku dhe e quajtmë si sukses, ku përfshihet edhe dypërqindëshi i TAP-it, që do të kalojë te pushteti vendor.

Për sa i përket këshillit konsultativ, unë jam shumë dakord me faktin që Komisioni për Çështjet vendore të bëhet pjesë e këtij Këshilli Konsultativ, pasi çdo draft do të trajtohet përsëri. Në këtë mënyrë mbase do të gjejmë një mbështetje dhe një suport të fortë për të ndryshuar dhe për të marrë në konsideratë opinionin e pushtetit vendor.

Për sa u përket strukturave të bashkive, nëse do t'u referohemi autonomisë vendore dhe ligjit për vetëqeverisjen vendore, ligjit 139, është kompetencë e kryetarëve. Me ligjin e ri, numri total i të punësuarve miratohet në këshill, ndërsa struktura është kompetencë ekskluzive e kryetarit dhe e administratës. Ajo që është vënë re nga ministria, paralelisht është vënë re edhe nga ne si shoqatë, por dhe evidentuar nga vetë kryetarët. Nuk është se këtu do të ketë cenim të autonomisë vendore, pasi kemi një dakordësi të opinionit, si të kryetarëve, ashtu edhe



të ministrisë, që të shkojmë drejt një standardi kombëtar. Edhe ky standard nuk duhet të jetë unik, por i ndarë në varësi të bashkive, të profilit të bashkisë, të madhësisë së bashkisë. Pra, mund të jetë i ndarë në tri-katër struktura, po përsëri nuk është taksative, por do të jetë diçka rekomanduese. Jam e sigurtë, të paktën nga komunikimet që ne kemi si shoqatë me anëtarët tanë, se do të ketë një mbështetje dhe një përkrahje, pasi bashkitë, pasi duke pasur strukturë të njëjtë bashkitë me të njëjtin profil, ndoshta është gjë e mirë edhe për shkëmbimin e eksperiencave mes tyre, si administratat, ashtu edhe vetë kryetarët, në lidhje me problematika të ndryshme. Kjo sepse ne kemi eksperiencën që, një praktikë të mirë të një bashkie ta shpërndajmë edhe te bashkitë e tjera. Në fakt, të dyja shoqatat së bashku kemi bërë edhe një studim, dhe ajo që kemi evidentuar është se praktika e mirë në një bashki, ishte problem në një bashki tjetër. Nëse ne do të bëjmë shkëmbimin e eksperiencave, do të zgjidhim shumë probleme. Paralelisht, në këtë mënyrë i vëmë edhe bashkitë në konkurrencë midis tyre.

Këto ishin shumica e atyre që doja të thosha. Aktualisht, sfida e pushtetit vendor është ecja paralelisht me pushtetin qendror, sa i takon ofrimin të shërbimeve online. Është një sfidë shumë e madhe, e cila nuk përballohet dot nga financat e pushtetit vendor, por ne po llobojmë, ndaj po e themi edhe këtu, që njëkohësisht të llobojë edhe ministria që përfaqëson pushtetin vendor, me qëllim që të gjithë donatorët ta fokusojnë vëmendjen pikërisht këtu, te shërbimet.

Ne mendojmë që, nëse do të kemi transparencë dhe gjithëpërfshirje, do të kemi edhe standarde më të mira në shërbime. Në fakt, pjesa e krijimit të standardeve minimale ka qenë një kërkesë e ardhur nga bashkitë, pasi duhet të ketë një standard minimal. Në momentin që kalon një shërbim apo një kompetencë në pushtetin lokal, paralelisht duhet të kalojë edhe një standard minimal kombëtar. Standardi minimal duhet të jetë taksativ dhe i realizueshëm nga bashkia. Më pas është vetë bashkia ajo, në varësi të prioriteteve të saj, në varësi të performancës financiare, që mund ta rrisë këtë standard. Ama, mendoj se miratimi i standardeve minimale të shërbimit është një nevojë emergjente, pasi në këtë mënyrë, ne do të arrijmë të masim edhe performancën e punës së bashkive.

Pra, këto janë disa indikatorë, të cilët masin performancën. Pastaj, vetë bashkia, administrata e bashkisë, do të jetë më e përgjegjshme, pasi ka një standard taksativ për të realizuar.

Faleminderit!

**Bashkim Fino** – Faleminderit!

Zoti Haxhimihali, drejtori ekzekutiv i shoqatës tjetër.

**Agron Haxhimihali** – I nderuar zoti Fino,

Shumë faleminderit për ftesën!

Në fakt, që në hyrje, pa filluar me detaje teknike, dua të them që, ashtu siç e tha edhe kolegja ime, unë personalisht mendoj se në marrëdhëniet institucionale me Ministrinë e Brendshme, gjatë këtyre viteve bashkëpunimi ka qenë krejt korrekt. Kemi shkëmbim informacionesh, pavarësisht pikëpamjeve të ndryshme. E rëndësishme është që përfshirja ka qenë e një niveli shumë të mirë. Shpresoj se, sido që të jenë rrethanat, modeli duhet të mbahet. Unë kam shpresë se zonja Kuko do ta mbajë këtë model.

Le t'u kthehemi çështjeve teknike.

Në fakt, unë e njoh qeverisjen vendore që në kohën kur ju kam pasur juve si Kryeministër, në vitin 1997. Mendoj se edhe në atë kohë ca gjëra funksiononin më mirë nga ç'funksionojnë sot.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mendoj unë, mendoj unë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mendoj unë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mendoj unë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mendoj unë, mendoj unë. Kisha më besim në atë kohë, në ato kushte, se sa në këtë kohë dhe në këto kushte.

Le t'u kthehemi çështjeve të decentralizimit administrativ dhe institucional.

Unë mendoj se, nëse u referohemi...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sa më bëhet qejfi që ka reagim, kur i drejtohem Zotit Fino!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Prit pra, ta mbaroj!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dallga është e padukshme aty ku jeni ju.

Megjithatë, le t'i kthehemi decentralizimit. Mua më duket se raportet për decentralizimin dhe reformën territoriale tregojnë se ka nevojë për t'u parë në mënyrë asimetrike kjo çështje. Po ju jap dy fakte: në qoftë se diskutojmë se kush mbledh të ardhura në 61 bashki në Shqipëri, duket një rritje prej 20 %. Në 61 bashki, po të përjashtojmë bashkinë e Tiranës, kemi një rritje prej 3% - 4 %. Ky nuk është sinjal i mirë për pjesën e 60 bashkive të tjera.

Në këtë drejtim, edhe për shërbimet dhe transferimin e funksioneve të reja, sigurisht që ne kemi qenë partizanë të idesë për t'i forcuar 61 bashkitë e reja, por ky katërvjeçar nuk më ka bindur të them se kemi performancë të mirë, kryesisht në bashkitë e mesme dhe të vogla.

Në konceptin tim, thjesht po i referohem opinionit tim si ekspert i qeverisjes vendore, mbase ka ardhur momenti kur duhet të fillojmë të mendojmë pak për të qenë më selektivë në listën e madhe të funksioneve, përgjegjësi dhe kompetencave që kanë bashkitë.

Po marrim si shembull një bashki të vogël diku në Jug apo në Veri. Ne themi: arsimi, shëndetësia, rendi, siguria e një sërë të tjerash, gjëra që duken si decentralizim jashtëzakonisht i mirë, po kur i kemi parë, kemi kuptuar se përbën një barrë shumë e madhe për shpatullat e qeverisjes vendore. Në këtë drejtim, asimetria mundet të jetë një objekt i dokumentit të strategjisë. Mbase nuk është zgjidhje afatshkurtër, por një zgjidhje afatmesme duhet konsideruar.

Lidhur me decentralizimin fiskal, në fakt vëmë re 1 % e GDP-së, që janë rreth 25 miliardë lekë, për të 61 bashkitë e Shqipërisë, sigurisht është për t'u përshëndetur, sepse ka ardhur me rritje nga viti në vit. Por, në qoftë se këtu kemi audiencë me kryetarët e bashkive, është e njëjta gjuhë që ne kemi diskutuar edhe para reformës: jo nuk kemi financa; jo me kaq lekë s'bëjmë dot një kilometër rrugë; jo nuk kemi mundësi e burime njerëzore; jo pagat janë shumë të ulëta dhe nuk mbulojnë kostot etj.

Pra, ka një sërë problemesh.

Normal, në këtë pozitë ne vetëm mund të kërkojmë, por unë respektoj edhe portofolin e shtetit tim, por a mos është momenti që këtyre 61 bashkive të reja t'u dyfishohet ky buxhet? T'ua japim atë pavarësinë financiare, të heqim dorë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E pakushtëzuar. Sipas zhargonit popullor, le t'i çojmë pak drejt ngopjes, kjo edhe në respekt të parimit të mjaftueshmërisë financiare.

Sa u takon transfertave të pakushtëzuara, e kam pasur opinion të kahershëm se duhet gjetur një modalitet, që tashmë t'u jepet edhe ajo bashkive. Ishte ndryshe kur kishim fragmentizimin. Sot që i kemi më të përqendruara, mendoj se qeveria qendrore duhet të heqë dorë nga investimet qendrore për çerdhe e kopshte e shkolla.

Unë kam propozuar që nga Fondi i Komitetit të Rajoneve, 20 % deri në 30 % të këtij fondi ta mbajë qeveria qendrore për investime rajonale apo strategjike, por pjesa tjetër është mirë t'u shpërndahet bashkive. Duhet ta ndryshojmë modelin sipas të cilit bashkitë duhet të rrinë nëpër zyrat e ministrive, si dikur: kap njërin, kap tjetrin, bëj projekte, bëj këto! Sipas meje, nuk është stil i mirë.

Dakordësohem plotësisht me zonjën zëvendësministre nëse do të arrijë të bëjë kalendarin detyrues, ka disa ligje dhe disa akte që ndoshta nuk prishin thelbin e gjësë, por unë mendoj se prej 5 vitesh themi: “komuna- bashkia”. Pse duhet të ketë ligji elemente parazitare që nuk funksionojnë? Kur bëhet fjalë për ligjet ndoshta duhet më tepër proces nga ana juaj, por kur ka disa akte kam përshtypjen se duhet ta përshpejtojmë procesin dhe t’i bëjmë një krehje të mirë kësaj situatë.

Për Këshilli Konsultativ, personalisht edhe pse kam një marrëdhënie të mrekullueshme me institucionin kam qenë kritik: Këshilli Konsultativ duhet të funksionojë sipas ligjit. Ai nuk mund të jetë një konferencë e hapur, ku vijnë 61 kryetarë, 30 donatorë, pra një mbledhje e hapur dhe ligjet kalojnë si produkte kineze. Kjo nuk më ngjall ndonjë gjë. Për mua Këshilli Konsultativ duhet të ulë palët, kryetarët, 9 zëvendësministra dhe diskutohen gjërat: duhet kështu apo ashtu, propozojmë 1 apo 2 gjëra. Vetë Këshilli Konsultativ, zonja Kuko është mirë të riorganizohet në këtë frymë. Për pjesën tjetër të PR-së mund të bëjmë 2 takime të hapura në vit, ku t’u themi donatorëve: “Strategjia ishte kjo, me të zgjedhurit ramë dakord...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, kështu. Konferenca të hapura nuk më tingëllon mirë.

Pjesa e borxhit, me thënë të drejtën është diskutuar. Meqenëse u bë kjo reformë e madhe strukturore ky borxh është një pikë ujë në krahasim me borxhin kombëtar që kanë bashkitë. Bashkitë duhet të ishin çliruar nga kjo gangrenë dhe do të ishte zgjidhje shumë e mirë, por sa kohë qeveria e gjykoi se po jep avantazhe me asete, me terrene, le ta mbajë edhe këtë. Jam dakord, po e pranoj. Por sot borxhi i ka vendosur bashkitë sërish në pozita shumë të vështira. Kam një kërkesë dhe një opsion tjetër. Borxhi ishte i ndarë, përfaqësohet kryesisht nga investimet që janë bërë dikur dhe nuk janë shlyer, nga dëmshpërblimet e gjykatave, si dhe shërbime apo mallra që kanë bërë vetë bashkitë. Propozimi im është i tillë, do të ishte mirë që pjesa e investimeve që ka shkuar në të mirë të shërbimeve publike t’u hiqej bashkive dhe bashkitë të mbanin përgjegjësi vetëm për borxhin kryesisht që shkaktohet nga largimet nga puna, që vazhdon të mbetet një problem i madh. Ky borxh është 6,4 miliardë lekë në të 61 bashkitë e Shqipërisë, 18-20% e këtij borxhi përfaqësohen nga detyrimet që ka bashkia nëpër gjykata si pasojë e dëmshpërblimeve dhe e largimeve nga puna. Mund të duhen 1 apo 2 mandate të tjera që bashkia t’u shlyejë borxhin punonjësve që ka larguar nga puna. Ky borxh mendoj se nuk duhet t’u hiqet bashkive dhe kryetarët të vihen para përgjegjësisë. Për investimet nuk duhet të fajësojmë kryetarët.

Lidhur me strukturën e bashkive jam dakord me kolegen time, ato janë institucione të pavarura dhe vendosin vetë, por njëfarë *benchmark* ka nevojë për t’u diskutuar. Orientimin se

mund ta bëjë ministria, personalisht e përkrah, duhet që edhe bashkitë t'i qasen kësaj gjëje. Standardizimi që një bashki për 1 mijë banorë, një ka 35, një tjetër ka 7, tregon se edhe standardi, cilësia e shërbimit nuk jepet njëlloj. Edhe kjo ka nevojë për t'u rregulluar me akte nënligjore.

Zoti Fino, një problem tjetër lidhet me njësitë administrative. Unë kam diskutuar me kryetarët edhe kohë më parë. Njësitë administrative për hir të së vërtetës janë disa qenie institucionale me një peshë shumë të ulët. Disa bashki, kam një informacion të kohëve të fundit, mendojnë t'i riorganizojnë edhe njësitë administrative, për shembull një bashki që ka 4-5 njësi administrative mund t'i grupojë në një të vetme, në këtë mënyrë edhe kursejmë kosto për administratorët, se nuk ka ndonjë ndryshim të madh, kanë lënë shumë punonjës nëpër njësitë administrative, por përgjigjja e tyre, po i referohem drejtpërdrejtë nënkryetarit të bashkisë së Tiranës, i cili tha: "Kur kanë bërë ligjin Fino dhe Çuçi këtë gjë nuk e kanë marrë parasysh".

**Bashkim Fino** - E para nuk ka të drejtë. Kur bëme ndarjen territoriale, të më korrigjojë drejtori i Përgjithshëm, do të mbetet siç e bëme ne. Më pas ne i kemi lënë të gjithë dritën jeshile këshillit të bashkisë, kryetarëve të bashkive që ta rishikojnë procesion e një riorganizimi brenda njësite administrative, siç e gjejnë ata, mund të shtojnë, mund të pakësojnë, ta përmbledhin më shumë, por e kanë ata në dorë. Kanë kaluar rreth 4-5 vjet dhe çdo gjë është në dorën e tyre apo e kam gabim? Në këto momente kjo që sapo the është çështje e tyre. Ata duhet të gjejnë, të flasin me komitetin dhe të vijnë në konkluzionin se duhet ta shkrijnë një njësi administrative, sepse shërbimet e saj mund t'i bëjë shumë mirë një njësi tjetër, është shtuar një lagje apo 2-3 të reja dhe mund të krijojnë një njësi tjetër të re. Kjo është fakultative, është në dorën e tyre dhe nuk është në dorën tonë. Në ligj e kemi lënë të hapur dhe kemi bërë mirë. Po ta kishim vënë në ligj, i cili miratohej me tre të pestat dhe t'i kishim thënë një bashkie të madhe: "Ti do të kesh 15 njësi administrative dhe nuk do të lëvizësh më", do të bënim gabim. Ne u kemi lënë dorë të lirë atyre.

**Agron Haxhimali** - Saktësisht kam interpretuar, se ne kemi qenë pjesë e këtij ligji, por kur vjen puna për hartat dhe për përcaktimin e kufijve kjo është ajo që na pengon.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Bashkim Fino** - Përcaktimi i kufirit është tjetër gjë dhe mënyra e riorganizimit të njësite të një bashkie është tjetër gjë. Nëse ti ke një problem dhe unë di se ka probleme dhe shumë shpejt Ministria e Brendshme me sa di unë, zëvendësministrja e Brendshme e tha që është në proces, do të sjellë një projektligj jo për ndarjen e re administrative, por për saktësimin e kufirit midis një fshati dhe një fshati tjetër apo të një lagjeje të një fshati që mund

të mos jetë brenda territorit të Bashkisë së Tiranës, por e marr si shembull, por mund të jetë brenda territorit të Bashkisë së Durrësit. Kjo është tjetër gjë, si puna e kadastrës, saktësimi i vijës kufitare.

Ndërsa riorganizimin e ndarjes territoriale me ligj e kemi lënë të hapur dhe ka kaluar afati kohor që ne kishim thënë: “Stop!”, e kishim ngrirë. Tani çdo gjë është në funksionin e kryetarëve të bashkive.

Çështja e dytë është një çështje që duhet të shikohet më tepër për saktësimin e kufirit dhe jo për gjë tjetër.

**Agron Haxhimali** - Dakord. Në pjesën e riorganizimit përveç numrit dhe strukturave, bashkia ka nevojë të shikojë edhe çështjet e decentralizimi të brendshëm, sepse më duket se nuk po shkon në shtratin e duhur kjo punë dhe ka formalizëm. Organigrama është gjë tjetër dhe strukturimi me njësitë, organizimi i tyre për shërbimet publike mund të jenë një gjë tjetër. Kaq kisha për momentin. Por nëse është e nevojshëm do të sjellim edhe përgjigjet me shkrim.

**Bashkim Fino** - Faleminderit!

Dëgjuam zëvendësministren, drejtorin e agjencisë, dy shoqatat e bashkive që janë prezente. Ne si komision dhe si anëtarë të komisionit të jeni të bindur se kemi diskutuar vazhdimisht qoftë në buxhetin e shtetit, qoftë në ligje të ndryshme që vijnë këtu për pushtetin vendor dhe kemi qenë si të thuash avokatë të kryetarëve të bashkive të pushtetit vendor, duke menduar se çdolloj funksioni që jepet i deleguar nga qeveria duhet të shoqërohet me faturë financiare, me numër dhe të gjitha me radhë, gjëra të cilat ndonjëherë kanë mbetur pa vëmendje apo gjëra që duhet t’ia japim pushtetit vendor duke mos i dhënë mundësinë financiare, por mundësinë në numër. Përgjithësisht deputetët dhe ky komision i nderuar ka qenë i prirë, ka anuar, për hir të së vërtetës më shumë nga organet e pushtetit vendor, sepse aty janë edhe shërbimet që bëhen në komitet sesa ndaj qeverisë. Aktorët që kemi përballë, zotërinj deputetë janë aktorët, të cilët përfaqësojnë avokatin e pushtetit vendor në qeveri. Unë mendoj që Ministria e Brendshme, zëvendësministra e linjës, apo drejtori i Agjencisë duhet të jenë më të fortë si avokatë mbrojtës të decentralizimit dhe të ligjit “Për pushtetin vendor” në qeveri në raport me ministrat e tjerë të linjës. Unë e di, për shkak edhe të eksperiencës që kam edhe si kryetar bashkie, edhe si ministër, se në shumë nga këto ligje që kemi bërë bashkërisht vështirësia më e madhe ka qenë te ministrat e linjës, të cilat nuk japin, nuk lëshojnë kompetencë ose edhe nëse e japin, e japin atë pa faturë financiare, pa numër të punonjësve. Prandaj edhe agjencia, edhe Ministria e Brendshme duhet të jenë avokatë shumë të fortë në qeveri për të luftuar fort. Por nga ana tjetër kërkoj që shoqatat, dy drejtuesit e shoqatave dhe të gjithë kryetarët e bashkive, sidomos në mbledhjen e Këshillit Konsultativ duhet të jenë

akoma më të “ashpër” ndaj ministrisë së linjës, ndaj problematikave që ju ngrini dhe diskutoni për të përfituar atë çfarë është e domosdoshme për organet e pushtetit vendor. Kjo duhet të mbahet në konsideratë.

Dua të them disa gjëra në planin strategjik, kjo është për ju zonja Zëvendësministre, shtyrja e afatit të strategjisë së decentralizimit si dhe aprovimi nga Këshilli i Ministrave i një plani të ri veprimi deri në vitin 2022 është një arritje. Kjo tregon se ne do ta shtrijmë planin strategjik të decentralizimit. Ndërkohë duhet të mendohet në mënyrë strategjike për të shtuar rrugët për fillimin e një procesi të hartimit të një strategjie të re decentralizimi. Unë jam autor i shumë prej këtyre ligjeve që kemi bërë, kemi bërë jashtëzakonisht shumë. Zoti Haxhimali tha, për vitin 1997. Në vitin 1997 nuk kishim ligj, por e bëmë në vitin 1998, bëmë edhe Kushtetutën. Më vonë miratua Kartën e Autonomisë Vendore që ishte në funksion të saj. Më tej pushtetet vendore kërkonin shumë kompetenca që nuk i kishin. Ne mundoheshim t’ua jepnim. Kulmin e arriti në qeverinë socialiste, kur bëmë reformën territoriale, që ishte një reformë historike. Ju e dini mirë se 373 njësi vendore nuk kishin dot mundësi, sidomos komnat e vogla të mbanin administratën e tyre me paga dhe jo më të bënin shërbimet, të bënim investimet e të tjera me radhë. Kjo reformë historike u shoqërua me ligjin nr.139 të vitit 2014 “Për decentralizimin”, i cili u shoqërua me ligjin “Për financat lokale”, i cili ishte kërkuar prej kohësh që në vitin 1990 e ca. Më në fund arritëm të kemi një ligj “Për financat lokale”. Me një ndërhyrje tuajën dhe tonën 2% e GDP-së do të jetë e paprekur ndaj pushtetit vendor. Nuk ka të drejtë Ministria e Financave të ndërhyjë për të dhënë grantin e pakushtëzuar, për të dhënë një fond për organet e pushtetit vendor, por kjo nuk mjafton. Të gjitha këto që kemi bërë janë një arritje e jashtëzakonshme në raport me bashkitë dhe rajonet që ka sot Europa. Kemi ecur jashtëzakonisht mirë. Por duhet që ky vendim që ka marrë qeveria për planin e ri të decentralizimit deri në vitin 2022 që për mua është një arritje, duhet të vlerësohet dhe duhet të ketë një matricë, siç tha zëvendësministrja me të gjithë kryetarët e bashkive dhe me shoqatat për ta ndjekur dhe për ta realizuar.

Duhet të fillohet të mendohet për procesin e angazhimit të partnerëve të nevojshëm ndërkombëtarë. Në planin strategjik ajo që ka munguar ndër vite është një sistem për matjen, për mendimin tim të progresit dhe të impaktit të masave në arritjen e objektivave të avancuar të decentralizimit. Kjo është matja. Ne i japim, por a mund ta matim se sa e kemi realizuar? Si e kemi realizuar? Çfarë mund të përmirësojmë? Ne kemi arritur një nivel cilësie pak më të lartë. Nuk jemi thjesht për t’ia dhënë pushtetit lokal. Tani problemi është që ta matim, ta vlerësojmë se sa është dhënë. Duhet të mendohet që tani për një sistem të tillë, i cili të na mundësojë lehtësimin e nivelit të zbatimit të funksioneve të decentralizimit dhe të

performancës së qeverisjes vendore në tërësi. Kjo do të ndikojë në një vendimmarrje më të madhe dhe realiste për prioritetet në të ardhmen. Kjo është pika më kryesore që e kam porosi të drejtpërdrejtë për Ministrinë e Brendshme, sidomos për Agjencinë. Nuk e kemi krijuar kot këtë Agjenci. Ne kemi qenë flamurtarët kryesorë të këtij komisioni me Kryeministrin Rama kur bëmë reformën territoriale dhe thamë: “Duhet të krijojmë një agjenci të vetëqeverisjes vendore”, që e kemi dhe për mua duhet të fuqizohet. Ministria e Brendshme duhet të mendojë që ta fuqizojë këtë agjenci, që do të thotë se ajo është nukli kryesor, për mendimin tim i një ndërlidhje midis Ministrisë së Brendshme dhe organeve të pushtetit vendor, por edhe i të gjithë donatorëve të huaj, të cilët vijnë dhe investojnë këtu për pushtetin vendor. Ajo duhet të jetë lidhja e pazgjidhshme midis shoqatave të bashkive me këtë Agjenci.

Zonja Zëvendësministre për mendim tim kjo Agjenci duhet të forcohet. Ne i kemi mundësitë dhe kapacitet për ta forcuar, jo thjesht për numër, por për ta forcuar në numër, në ide dhe mendime në funksion të kësaj strategjie të re që do të bëjmë deri në vitin 2022.

Kam folur me ministrin tuaj dhe më ka thënë: “Shumë shpejt do ta shikojmë strukturën për të bërë edhe drejtori të përgjithshme të pushtetit vendor në ministri”. Shumë mirë! Kjo është një gjë shumë e mirë, qoftë drejtori prefekturë, qoftë drejtori të Përgjithshme të pushtetit vendor në ministri për të bërë politika, por Agjencia ka tjetër rol. Agjencia duhet të jetë atje si një gur i çmuar që e kemi krijuar në vitin 2014 dhe të forcohet akoma edhe më shumë. Pjesa tjetër e drejtorive që ju do të keni brenda funksionit politik të ministrisë për mendimin tim modest, që e njoh mirë pushtetin vendor janë pjesë të një drejtorie të politikëbërjes. Janë shumë të rëndësishme, sepse bëjnë projektligje, akte nënligjore, por një revizionim më të mirë të tyre e bën pikërisht kjo Agjenci me shoqatat, e bëjnë donatorët e huaj që janë mbi ne. Prandaj këtë duhet ta kemi më shumë parasysh.

Lidhur me matricën e kompetencave, më lejoni t’ju them 2 gjëra për shkak të njohjes që kam, të cilën e kemi hartuar dhe në mbështetje me BE-në, përshkuam të gjitha boshllëqet, mbivendosjet, konfliktet e legjislacionit që thatë ju. Te ligji nr. 139 të vitit 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” është i rëndësishëm monitorimi, pra të shikojmë si ecën dhe rishikimi i legjislacion, hartimi i akteve nënligjore siç e thatë edhe ju në zbatim të ligjit nr. 139. Ligjin e kemi bërë shumë të mirë. Një ligj i mirë merr vlera të jashtëzakonshme në qoftë se atë ne e monitorojmë mirë dhe nxjerrim aktet nënligjore të përputhura për çdo nen të caktuar të tij. Po t’i nxjerrim këto akte nënligjore në funksion të ligjit, të jeni të bindur se ligji do të jetë ekselent në zbatim. Do të zbatohet, por, kur nuk ka akte të ndryshme nënligjore, ai ngelet pa zbatuar. E çfarë më duhet mua një ligj i bukur në letër, që e bëj, madje më jep vlerësim edhe BE-ja, ndërkohë që është i pazbatueshëm në disa sektorë të ndryshëm?!



Domethënë, zëvendësministri i Brendshëm, në rastin konkret ju, zonjë, Agjencia dhe shoqatat duhet të marrin një rol jashtëzakonisht proaktiv, për mendimin tim dhe të komisionit që drejtoj, pra jo vetëm të presim veprimet nga ministrinë e linjës, se, po pritëm nga ministrinë e linjës, ne jemi të mbaruar. Këtë e them me plot bindje, nuk është kritikë kjo, por është një logjikë që ka ndodhur konkretisht në terren. Ministrinë e linjës, edhe unë, po të isha një ministër linje sot, do të kisha prirjen t'i mbaja vetë pushtetet dhe të mos i delegoja tek organet e pushtetit vendor. Por cilat janë instrumentet, me të cilat ne duhet ta zhbëjmë këtë? Në rastin konkret, jeni ju të katërt apo edhe drejtorinë që do të krijoni, në mënyrë që të mos presim nga ministria e linjës, por ne e shpiem draftin në këtë Këshill Konsultativ, e miratojmë, e bëjmë gati dhe ia lëmë mbi tavolinë Kryeministrit në mbledhje qeverie. Ministri i linjës është një atje, në raport me vendimmarrjen politike të qeverisë, dhe nuk ka çfarë bën. Edhe në qoftë se do të ketë rezistencë, do të vijë në parlament, do të kalojë ligji dhe këtu në parlament, shumica janë, të jeni bindur, me krahun tuaj për të kaluar dhe për të mos lënë...

Më thoni, dhe unë jam shumë i interesuar t'ju them, që ne i kemi kaluar disa kompetenca, por për mua janë kompetenca gjysmake. Unë e kam thënë vazhdimisht: shumë bukur që i kemi kaluar kompetenca. Do të marrim arsimin, do të marrim shëndetësinë, do të marrim mjedisin, do të marrim cilëndo ministri do ti? Unë e marr dhe ta zbërthej tani, duke thënë: këto janë kompetencat që ka pushteti vendor, këto janë kompetencat që ka ministria. Me kompetencat që ka pushteti vendor janë tallur, ndërsa këto kompetencat i mbajnë vetë, sepse duhet të mbajnë ministrinë e linjës. Kjo do të thotë që, në qoftë se ti më jep arsimin parashkollor, shumë mirë, por, në qoftë se mua, si kryetar bashkie, më kërkon mundësinë që të pastroj, të rregulloj, të meremetoj, të investoj shkolla e kopshte në territorin tim të bashkisë, shumë mirë, unë e kam për detyrë, por pse nuk e paskam për detyrë unë që të emëroj mësuesit e mi?!

Kurrikulat bëji ti, si Ministri e Arsimit, nuk ndërhyj tek ajo unë, sepse është çështja jote, është e ministrisë, është politikëbërja, por të drejtën e arsimtarëve për t'i vendosur në një bashki e kam unë, si kryetar bashkie, dhe këshilli bashkiak përkatës. Të drejtën për të kontrolluar ti si ministri linje, flas në rastin konkret të arsimit, absolutisht ta kesh ti. Vjen të kontrollosh në bashkinë time dhe nuk gjen performancë të mirë në bazë të kurrikulës së arsimtarëve që kam unë, ti si ministri ke të drejtë ta shkarkosh, sepse nuk mund të lejosh t'i arsimojë fëmijët një arsimtar që nuk ka nivelin e duhur. Ama, emërimin brenda territorit të bashkisë sime duhet ta kem absolutisht unë, mbi bazën e kurrikulave që më jep ti. Ky është decentralizim pushteti, me vlerë dhe reale, por këtë decentralizim ne e kemi bërë të cunguar: kemi dhënë një pjesë dhe nuk kemi dhënë një pjesë tjetër. Jo, ne duhet, madje ka ardhur koha tani, se jemi në vitin 2020, të japim një gjë tjetër.

Çfarë tha dje, pardje, kryetari i Bashkisë së Tiranës? Tha: “Fillon shekulli i ri i 100-vjetorit të ri”. 100 vjet! Ne nuk kemi ligj për kryeqytetin, por duhet të kemi ligj urgjent për kryeqytetin, siç e kanë të gjitha vendet e tjera të botës. Çdo kryeqytet i botës ka ligjin e tij, në funksion edhe të ligjit që ka pushteti vendor, por duhet të ketë ligjin e tij. Tani në 100 vjet, t’i thuash kryetarit të bashkisë, kushdo qoftë ai, nuk bëj politikë fare: “Jo, arsimtarët do t’i emëroj unë, sepse unë jam më i zoti si ministër i Arsimit; infermierët do t’i emëroj unë, sepse jam më i zoti unë si ministër i Shëndetësisë nga ty, si kryetar bashkie”, që, po ta marrësh në aspektin, si të thuash, e përzgjedhjes, një kryetar bashkie, për mendimin tim, ka një vlerë, sepse ka një votë popullore shumë herë më të lartë nga një përzgjedhje imja si Kryeministër që marr iksin, ipsilonin, si ministër për të vazhduar dhe për të bërë ekipin tim drejtues, apo jo. T’i i them këto, sepse ne duhet të vrasim mendjen për t’i zgjidhur sa më mirë dhe sa më drejt.

Për sa i përket Këshillit Konsultativ, ku u ndalët, krijimi dhe funksionimi i Këshillit Konsultativ ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore është një arritje shumë e rëndësishme, për hir të së vërtetës (më lejoni të bëj pak politikë), e qeverisë socialiste. Duhet ta thosha këtë, sepse kam qenë nga nismëtarët që e kam bërë ligjin dhe jam interesuar. Ne kemi bërë jashtëzakonisht shumë në raport me Partinë Demokratike për pushtetin vendor. Agroni e di shumë mirë se sa shumë gjëra kemi bërë ne si Parti Socialiste, kur ishim në pushtet dhe kur jemi për decentralizimin dhe për pushtetin vendor. Madje, ne kemi marrë më shumë nga ministrat, ndërkohë që unë kam qenë kryetar bashkie me një qeveri demokratike, me qeverinë e PD-së “Meksi” dhe me President Sali Berishën.

A e dini ju që në periudhën 1992-1996, kur unë kam qenë kryetar bashkie, më vinte numri dhe fondi i pagave nga qeveria, nga Ministria e Pushtetit Vendor, nga zoti Njazi Kosovrasti, që është miku im dhe njohës shumë i mirë i pushtetit vendor? Më vinte me numër dhe unë nuk kisha asnjë të drejtë, pale më të bëhej fjalë që unë në Gjirokastrën time të kisha mundësi të bëja investime; pale më të më jepej mundësia që unë të bëja një *joint venture* me një bashki motër, siç ishte Janina në rastin konkret. Por shikoni sa kemi ndryshuar ne në raport me atëherë, kur sa filluan, për hir të së vërtetës, organet e pushtetit vendor. Nuk vë faj, sepse, realisht, sa filloi, sa u zgjodhëm ne direkt nga populli, kishte shumë probleme që duhej të zgjidheshin. Por sot ne nuk diskutojmë më nga këto. Çfarë po diskutojmë ne? Diskutojmë që këshilli bashkiak miraton numrin. Ku kishte këshilli bashkiak asokohe të drejtë të miratonte numrin? Atëherë, na vinte nga Ministria e Financave që kaq do të ishin. Ne edhe këtë iniciativë që merr Ministria e Brendshme, dhe unë e përgëzoj për strukturën dhe bën shumë mirë (se disa e bëjnë super të fryrë strukturën, disa e bëjnë korrekte, ngrihen shoqatat, në rastin konkret këta të dy)... Ata që e përfaqësojnë nga mbrapa thonë: “Pse ndërhyni ju në kompetencat e mia?!”

Kjo është si puna e këtyre të federatave të futbollit, të basketbollit, të volejbollit, të cilat na thonë: “Mos ndërhyni”, a thua se aktivitetin nuk e bëjnë në Shqipëri ata! Si, ore, të mos ndërhyj unë në strukturën tënde?!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë nuk do të ndërhyj se sa inxhinierë do të kesh, por do të ndërhyj dhe do të të them: ti e miraton vetë tani numrin me këshill, se ta kam lënë në ligj që strukturën e bën vetë ti, kryetar i bashkisë; të kam lënë në ligj që, ti, kryetari i bashkisë, e vendos vetë nënkryetarin e bashkisë; e emëron, e shkarkon kur të të dojë kokrra e qejfit! Është kështu, apo nuk është kështu? Kështu e kemi bërë.

Tani, kur të kam bërë të gjitha këto gjëra, ti duhet të ecësh në një performancë me të gjithë: me qeverinë, me ministrinë, me drejtoritë përkatëse politike, që ka ajo zonja atje, se si duhet të jenë strukturat. Ne e dimë shumë mirë tani, edhe ne që jemi në pushtetin qendror apo në parlament, se sa drejtori shërbimesh mund të ketë një bashki dhe çfarë shërbimi mund t'i bëjë. Prandaj Këshilli Konsultativ është shumë i rëndësishëm dhe është për t'u përshëndetur roli i agjencisë, për mendimin tim, si dhe i Ministrisë së Brendshme për intensifikimin e takimeve të këshillit.

Ju na ftuat në mbledhjen e datës 25, tha zonja zëvendësministre. Të jeni të bindur, madje faleminderit që na ftuat për herë të parë, se do të vijmë në tryezë si dëgjues, sepse, në fund të fundit, ne e mbyllim qarkun, në kuptimin që ato që nuk thuhet atje do të vijnë këtu në parlament, ku kolegët e mi do të diskutojnë dhe do të ngrenë dorën, nuk diskutohet, por, absolutisht, unë jam dakord që duhet të ketë një lidhje ndërmjet Këshillit Konsultativ dhe të paktën Nënkomisionit për Pushtetin Vendor, ku ka specialistë, ekspertë, kanë qenë këshilltarë, kryetarë bashkie dhe sot janë deputetë, të cilët mund të japin më shumë mendime dhe sugjerime në këtë këshill që projektligjet, pretendimet dhe aktet e tjera nënligjore të vijnë sa më të sakta këtu te ne dhe të kemi sa më pak punë për të miratuar. Gjithsesi, unë mendoj që ky këshill duhet të bëhet efektiv dhe, që të bëhet efektiv, është ajo që tha edhe Haxhimali, ne nuk mund të bëjmë *show*, atë le ta bëjmë, absolutisht, por mbledhja e Këshillit Konsultativ për mua duhet të jetë një debat i fortë profesional i pushtetit vendor, ku të ketë debate për projektligjet dhe për projektaktet, të cilat të na japin mundësinë të dëgjojmë alternativat dhe kundëralternativat e një projektligji, se cila është më e mirë dhe si bëhet më mirë. Natyrisht, aq mundësi sa ka qeveria për të na dhënë, do të na japë edhe për pushtetin vendor.

Më lejoni të flas pak për mbështetjen e huaj dhe decentralizmin e qeverisjes vendore, që e kam merak dhe t'jua u them juve. Nuk e prekët ju të gjithë, por unë dua të them që në fillim se është me rëndësi të maksimizojmë përfitimin e efektivitetit të mbështetjes së huaj në

fushën e pushtetit vendor. Ka disa donatorë që në kohën time, disa tani janë ende, që kontribuojnë me projekte aktive për decentralizimin dhe qeverisjen vendore, ku ndër më të rëndësishmit janë vetë BE-ja, PNUD-i, Suedia, Italia, Zvicra, është projekti “STAR”, të cilët, jam shumë i bindur që edhe ju në shumë takime që keni bërë, i keni falënderuar. Edhe unë gjej rastin në emër të Nënkomisionit t’i falënderoj për punën e jashtëzakonshme që ata kanë bërë, për ndihmën e jashtëzakonshme financiare që kanë dhënë, por edhe që kanë kontribuar në decentralizim dhe në kompetenca. Kanë kontribuar jashtëzakonisht shumë dhe, në momentin kur kanë kontribuar kaq shumë, ne duhet t’i mbajmë fort ata, duhet t’u hapim punë atyre, madje duhet t’u themi: kemi nevojë për punën dhe për donacionet tuaja.

Më lejoni të them, zonja Zëvendësministre, këtë do t’ia transmetoj edhe ministrit, edhe Kryeministrit, që realisht këta donatorë jo vetëm duhen mbajtur fort, por, në qoftë se ka projekte të tjera, urgjentisht t’i marrim dhe t’i firmosim projektet me ta, sepse na interesojnë. Marrim mësim edhe çfarë bëjnë ata në Suedi, në Zvicër, në Itali e kështu me radhë, në BE, por, nga ana tjetër, është një qasje shumë e mirë edhe për administratën tonë, sidomos për administratën e pushtetit vendor. Kështu që mbështetja e donatorëve nëpërmjet kontributit të përbashkët, që filloi nga viti 2014 me reformën territoriale, me sa mbaj mend, kam punuar me projektin “STAR I”, kur isha këtu kryetar me zotin Çuçi, i cili ishte ministër Shteti, ka rezultuar të jetë shumë efektive. Kjo mbështetje ka vijuar dhe mbetet e tillë edhe në fazën e saj të dytë, por edhe në vetë karakterin dhe në kontributin e drejtpërdrejtë të objektivave të saj. Prandaj projektet “STAR I” dhe “STAR II”, për mendimin tim, kanë kontribuar, në radhë të parë, në realizimin e reformës, që ishte objektiv i rëndësishëm dhe kombëtar për një qeverisje vendore efektive, por edhe më tej në konsolidimin e 61 bashkive. Nuk mendojmë se i kemi konsoliduar shkëlqyer, por kemi bërë një punë të mirë. Ka disa arritje të rëndësishme në fazën aktuale në drejtimin prioritar, që janë objekt i vlerësimit periodik për anëtarësimin e vendit në BE: demokracia vendore, që është transparenca, pjesëmarrja dhe konsultimi publik; përmirësimi, ofrimi i shërbimeve administrative dhe atyre publike; përmirësimi i kapaciteteve administrative nëpërmjet trajnimeve të fushave të ndryshme. Një ndër arritjet e rëndësishme të kësaj asistence mund të listoj edhe sistemin e informatizimit, që e përmendët edhe ju, të zyrës me një ndalesë, që e përmendi edhe drejtori i agjencisë. Kjo zyrë ka qenë shumë efektive. Unë e kam ndjekur. Unë jam deputet në Lushnjë, ku e kemi bërë gjithashtu, por edhe zyrat e ADISA-s janë tejet të rëndësishme për t’i dhënë shërbime të menjëhershme qoftë pushtetit vendor apo atij qendror. Kjo është një nga reformat e forta që po bën qeveria jonë në këtë drejtim.

Që në gjenezë është konceptuar si një mënyrë për të reduktuar ndjesinë e distancës së qytetarit, se ndaj e bëmë ne të qeverisjes vendore për t’i dhënë një impakt më të mirë reformës

territoriale. Prandaj, dhënia e shërbimeve ndërmjet sistemit duhet të kishte avancuar edhe më shumë, sepse për këtë qëllim e bëmë edhe ndarjen territoriale. Pra, nuk e bëmë që të largohej shërbimi larg, por që shërbimi të shkonte pranë qytetarëve. Prandaj, Agjencia dhe Ministria e Brendshme duhet ta intensifikojnë, për mendimin tim, komunikimin me bashkitë lidhur me obligimin për të ofruar shërbime nëpërmjet këtij sistemi që sapo e përmenda. Sistemi duhet medoemos të bëhet funksional në të gjitha njësitë administrative që ka sot çdo bashki. Po u bë funksional në çdo njësi administrative, ne kemi shpëtuar: e kemi ndihmuar qytetarin dhe komunitetin me shërbimin që kemi bërë, dhe qytetarët fillojnë të gjejnë dhe të gëzojnë frytet e marrjes së shërbimeve në kohë sa më të shpejtë.

Pengesat dhe ndryshimet ligjore duhet të adresohen në atë mënyrë që burokracia e dhënë e këtyre shërbimeve administrative të reduktohet në maksimum. Kjo është në linjë me vizionin dhe me prioritetet e Kryeministrit të kësaj qeverie dhe ju e dini që ai flet shpesh për këtë çështje, ndaj na takon edhe neve, në fakt, juve në radhë të parë që jeni atje që, nëpërmjet këtyre projekteve, ta monitorojmë.

Vijmë tani tek transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje, që janë shumë të rëndësishme. Është me rëndësi të kuptohet jo thjesht, sepse ne nuk e kemi vënë kot në ligj, por e kemi vënë për t'i thënë qytetarit që ti je njeriu që vjen flet në këshillin bashkiak; ti një njeriu që vjen e thua: unë dua të bëhen një, dy, tri gjëra në qytetin tim. Është këshilli pastaj, nisur nga përzgjedhja që ti i ke bërë atij këshilli, se sa vendime do të marrë, se sa mundësi financiare ke, por transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje është shumë e rëndësishme për t'u kuptuar nga kryetarët e bashkive dhe nga këshilli bashkiak. Këshillat bashkiakë nuk janë për të bërë qokat e veta të lagjeve të veta, se ka edhe raste të tilla, zonja Zëvendësministre, pra edhe ju të shoqatës duhet të luftoni me kryetarët e bashkive.

Unë nuk jam zgjedhur këshilltar në bashkinë time, atë të Lushnjës, që të zgjidh problemin e rrugës së lagjes sime. Jo, jam zgjedhur atje që të di të gjithë problematikën e qytetit tim dhe, kur të marr *feedback*-un nga të gjithë njerëzit se çfarë pretendimesh kanë, të shikoj mundësinë se kush është më keq, cila është popullsia më e madhe që i shërben më shumë dhe atje ta ngre dorën për të bërë atë investim, jo këshilltari të jetë në funksion të lagjes së tij dhe të thotë: e bëra unë dhe jam në rregull.

Mirë, ja e bëre ti një rrugë të lagjes sate, po tre vjet të tjerë, që ti je aktiv në atë këshill bashkiak, çfarë do të bësh?! Prandaj, transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve është shumë e rëndësishme për mua.

Doni t'jua them më shkoqur dhe më politikisht? Jua them: kjo është në linjë me nismën "Për Shqipërinë që duam". Sepse, në qoftë se ti bën transparencën, i dëgjon, i bën, kjo është

ajo që themi ne: Shqipëria që duam. Duket si politike, por, në fakt, nuk është politike. Të flasësh, t'u prezantosh programe, arritje, kapacitetet e kufizuara buxhetore të përzgjedhjes së investimeve, prioritetet që i do shumica e qytetarëve, për mendimin tim, përbën një qeverisje të suksesshme. Prandaj, duhet të jemi strategjikë në këtë aspekt, pasi është me përfitim të dyfishtë, si për popullaritetin e të zgjedhurve, të cilëve iu rritet vlera, ashtu edhe në vlerësimin e partnerëve. Këto aspekte marrin një rëndësi të veçantë në kushtet aktuale, më lejoni t'ju them këtë gjë, duke vlerësuar opozitën aktuale të parlamentit, kur ne po qeverisim pa opozitë në nivelin lokal. Kjo transparencë dhe pjesëmarrje e qytetarëve ka vlerë të jashtëzakonshme, ka vlerë për nismën "Për Shqipërinë që duam", që do të thotë se asnjë qytetar i bashkisë sime, ku unë jam deputet, të mos ndihet i cenuar, se është i një partie tjetër dhe nuk është i përfaqësuar nga kryetari i bashkisë apo nga këshilli përkatës. E dimë shumë mirë që një pjesë e opozitës nuk mori pjesë në zgjedhje, absolutisht jo, dhe në këtë aspekt merr një rëndësi të veçantë, pasi ne duhet të qeverisim në një nivel vendor pa opozitë. Duke qeverisur pa opozitë, do të thotë që ne duhet të bëjmë punën për të gjithë njerëzit tanë, për të gjithë njerëzit që janë aty.

Prandaj, në përfundim, më lejoni t'ju them që gjithçka thamë për çështjet e plotësimit të matricës, që ju e thatë dhe e keni sjellë këtu, do ta ndaj nga një kopje të matricave të vetëqeverisjes vendore për të gjithë anëtarët e komisionit, për bashkitë në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian apo edhe aktet ligjore dhe nënligjore që kanë dalë, strukturën për të cilën ju jeni të interesuar, Këshillin Konsultativ, por, në mënyrë të veçantë, analiza e decentralizimit, që ne kërkojmë, është një gjë shumë e mirë.

Do të kërkoja nga kolegët e mi, meqenëse fola para tyre duke dhënë disa përgjigje të të gjithë diskutimit që bëtë ju, edhe si njohës i pushtetit vendor, që ne duhet të jemi më monitorues ndaj jush në sensin pozitiv, jo në sensin negativ që të vijmë të kontrollojmë, por të jemi më monitorues ndaj Këshillit Konsultativ, ndaj vendimmarrjes së Ministrisë së Brendshme, ndaj vendimmarrjes së Agjencisë, si dhe ndaj mendimeve dhe sugjerimeve që japin bashkitë dhe shoqatat e bashkive. Duke qenë sa më monitorues ne, mendoj se do t'ju japim një shtytje organeve të pushtetit vendor dhe do të jemi më të përgatitur në çdo projektligj që do të vijë këtu apo edhe në çdo projektbuxhet, pasi ne kujtohemi për pushtetin lokal vetëm kur vjen projektbuxheti i vitit. Pyesim: sa e kemi dhënë grantin e pakushtëzuar? Se atë kërkoi ai: të rritej granti i pakushtëzuar. Sa e kemi dhënë në raport me vitin e kaluar? Jam plotësisht dakord unë, edhe me sugjerimet dhe vërejtjet që bëre ti. Por, para se ti bësh ti, që je opozitë, i kam bërë unë me koshiençë dhe kam thënë me bindje të plotë që Fondi i Rajoneve është një e metë e domosdoshme, më lejoni ta them...

Ju thatë këtu: “Le t’i mbajë qeveria ato”, ju jeni më tolerantë, por unë jam edhe më shumë. Ti the që 20%-30% mund t’i mbajë qeveria te Fondi i Rajoneve për të bërë investime rajonale e të tjera, ndërkohë që unë personalisht jam absolutisht kundër, sepse e njoh pushtetin lokal. Ka dy palë fonde, një fond të pakushtëzuar që i jepet në formë granti pushtetit vendor, por edhe fonde të tjera, që i kanë ministritë e linjës për investime të linjës së tyre. Nuk ka më fonde të tjera qoftë të një rajoni, qoftë të një...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë jam dakord edhe me sugjerimin që bën ti, është një e mesme e artë ajo që thua ti, që krijojmë një fond 30%-40% që rajonet i kanë, kur ka investime rajonale që prekin 2-3 bashki dhe duhet të ndërhyjë, absolutisht, jam me ty, por fondet janë fonde dhe, kur ato fonde janë, ndaj quhet fond i pakushtëzuar. Por problemi është gjithmonë që ne kërkojmë.

Të vijmë tani te pjesa e fundit dhe mbarova. Po pjesa tjetër që ne duhet, jo vetëm të kërkojmë, por edhe të japim atë çfarë na jep ligji, domethënë si është performanca e kryetarëve të bashkive, e këshillave dhe administratës në vjeljen e taksës lokale, në vjeljen e taksës së pasurisë? Sa punojnë ata? Nuk më thatë asnjë fjalë. Kjo do të thotë që, po të marrim ta bëjmë këtë analizë, dhe e tha zëvendësministria shkarazi, por kur flet ajo shkarazi, është e vërtetë, që ne mund të bëjmë një mbledhje tjetër për financat lokale, ku të bëjmë një detajim më të hollësishëm, ju si shoqatë duhet të vini këtu me të dhëna të detajuara, se si është performanca e çdo bashkie, ndaj i bëmë 61 me këto të ardhura lokale, sepse unë pretendoj që nuk janë në bashki të viteve ’92-’96, ku 90% apo 95% e fondeve ishin nga qeveria dhe shumë pak kisha nga të miat. Ne duhet të pretendojmë, siç e ka edhe sot Europa, që të ardhurat lokale duhet të jenë më të larta nga dhënia e grantit të pakushtëzuar. Kjo do të thotë që ti më kërkove rritje të grantit të pakushtëzuar. Unë e kërkoj në çdo mbledhje, kur vjen buxheti, por në thelb ne jemi në shekullin tjetër të ri tani, flas për Tiranën, pra duhet të kalojnë raportet e përqindjes së të ardhurave të tua personale. Kur them “personale”, e kam për bashkitë, në raport me grantet që jep qeveria. A ka mundësi t’i kalojmë këto në raportet 60% me 40%? Kjo do të jetë arritje e jashtëzakonshme e një bashkie se, po të jesh ti i fuqishëm financiarisht dhe të krijosh vetë 60% të të ardhurave, atë 40-çen e ke pastaj... Por, kur sot je te 70%, që ta jep qeveria, dhe vetëm 30% e realizon nga të ardhurat, ngelen, siç e the ti fjalinë, kryetarët e bashkive nëpër dyert e ministrave. Jo, more, nuk kanë punë kryetarët e bashkive në dyert e ministrave, por ministrat kanë punë të shkojnë në derën e kryetarit të bashkisë; duhet të jetë e kundërta! Pse nuk është kjo? Sepse performanca e tyre, puna e administratës, e taksave vendore e të tjera me radhë nuk janë në nivelin e duhur.

Po marr vetëm elementin e taksës së pronës, që ne e kemi nxjerrë dhe kemi thënë: ta marrë bashkia. Sikur ta realizojë bashkia këtë element, të jesh i bindur se nuk ka nevojë as për grantin e pakushtëzuar, që unë dhe ti po e luftojmë fort, as për Fondin e Rajoneve. Pra, nuk ka nevojë fare t'i paraqesë qeverisë projekte, cili është më i bukuri dhe cili më i miri, dhe mbi bazën e atij projekti të fitojë. Fare-fare, nuk dua ta di fare unë, po të isha kryetar bashkie dhe po të kisha mundësi të realizoja 70%-80% të të ardhurave të mia vetëm nga taksat lokale. Nuk më interesonin fare as granti dhe as Fondi i Rajoneve, apo nuk është kështu? Prandaj unë them që takimet e ardhshme ne duhet t'i bëjmë të monitoruara për të gjithë problematikën e punës suaj.

Ndaj, na dërgoni, ju lutem, zonja Zëvendësministre, axhendën e mbledhjes së Këshillit Konsultativ për datën 25 (se çfarë do të trajtohet) që ta kenë të gjithë deputetët e Nënkomisionit të Pushtetit Vendor që të jenë pranishëm dhe mbledhjen e ardhshme duam ta bëjmë me një *start* tjetër, me problemet financiare, për të hyrë dhe për të diskutuar në mënyrë më teknike dhe më të detajuar.

Të nderuar kolegë, u zgjata pak, duke marrë kohë nga koha juaj pa dashur të ndërhyj, se keni të drejtën e Zotit për të bërë pyetje dhe për të folur. Meqenëse i dëgjova të 4 përfaqësuesit me kujdes dhe e kam marrë materialin që ka bërë agjencia, e lexova dhe studiova pardje dhe dje dhe jam munduar të jap një përgjigje, ndaj e bëra këtë diskutim paraprakisht për t'ju ndihmuar nëse nuk keni gjë për të thënë. Më falni, që e mora fjalën para jush, e bëra në mënyrë asimetrike, pra në drejtim të kundërt me atë që bën Ulsi, se nuk drejtoj dot si Ulsi unë.

**Edlira Hyseni** – Përshëndetje!

Ju falënderoj për prezantimin!

Në fakt, siç tha dhe kryetari, çështjet kryesore u përmbledhën, pavarësisht se ishte një përmbledhje pozitive dhe me përmbajtje politike, sepse vërtet “Shqipëria që duam” është një logo e PS-së, por jemi të gjithë qytetarë të këtij vendi dhe një Shqipëri më të mirë e duam të gjithë. Për këtë jemi dakord, pavarësisht se u përdor për të vënë në dukje sukseset e qeverisjes.

Unë jam deputete e Durrësit dhe kam qenë edhe anëtare e këshillit bashkiak të Durrësit për 4 vjet, para se të merrja mandatin, prandaj i njoh pak a shumë problematikën nga afër. Ju bëtë një përmbledhje të ligjit për reformën territoriale dhe thatë që ka 4 vjet që është implementuar kjo reformë dhe mund të keni një bilanc dhe se këtë vit do të shihni më mirë bilancin, apo do të bëni një analizë më të saktë të rezultateve të kësaj reforme. Unë, në fakt, mendoj se ky është një vit pak kaotik dhe i vështirë, sepse ato që themi ne mund të jenë shumë teorike, por përgjithësisht, është praktika dhe janë financat ato që përcaktojnë shumë nga objektivat që duam të realizojmë. Siç e dini, situata e tërmetit, pasojat dhe fatura financiare që



e ka shoqëruar, parashikon se do të kemi vështirësi të natyrave të ndryshme, sidomos financiare. Buxhetet e bashkive të prekura, si Bashkia e Durrësit, e Tiranës, e Laçit dhe e Krujës mund të ndjejnë mangësi në fondet që presin, ose mund të kenë të mira nga kjo punë, por do ta shohim.

Viti që jemi mund të jetë vit i vështirë financiar dhe mund të penalizojë, ose cenojë financat vendore, nuk e di nëse me buxhetin e fundit të miratuar u arrit përqindëshi r kërkuar, pra 0,8% -1%, gjë që shpresojmë të përmbushet gjatë vitit 2020. Kemi të bëjmë me një vit të ri edhe politik, ku për herë të parë të gjitha bashkitë janë monopartiake, ashtu sikurse disa bashki janë pa kryetar, sepse janë në pritje të një procesi rizgjedhjeje. Nuk e di si do të zgjidhet. Këshillat bashkiakë aktualë janë përfaqësues të vetëm një partie, ka shumë pak anëtarë tek të tjerat.

Mendoj se roli i këshillit bashkiak është shumë i rëndësishëm në vendimmarrje, sepse, në njëfarë mënyre, ridimensionon fuqinë që ka kryetari. Ne e dimë shumë mirë që në Shqipëri kryetarët kanë fuqi absolute, por këshillat bashkiakë i ndihmojnë ndonjëherë, për të marrë vendime më të mira, sidomos gjatë periudhës së buxhetimit vendor, që është një proces, i cili kërkon një përfshirje të qytetarëve, apo të konsultimeve publike. Përtej sukseseve që ju parashtruat, më tërhoqi vëmendjen përmendja disa herë e standardeve kombëtare. Kam përshtypjen që synoni realizimin e standardeve kombëtare për financa vendore, shërbime vendore dhe struktura vendore. Ndoshta është një model që synoni ta realizoni, por nuk e di për çfarë konkretisht, sepse të gjithë ju iu referuat disa herë faktit që mungojnë standarde kombëtare dhe duhen hartuar, zbatuar, apo realizuar. Cilin model keni parasysh? Kujt po i përafrohemi? Kujt do t'i ngjajmë, ose çfarë na mungon konkretisht?

Kryetari është hartuesi, mbrojtësi i të gjitha sukseseve të reformës, por unë isha kurioze të dija, pas këtyre 4 viteve a mund të themi që kjo reformë territoriale e ka realizuar objektivin e saj, që do të thotë reduktim të kostove administrative në nivel të përgjithshëm dhe përmirësim të shërbimeve ndaj qytetarëve kudo që janë? Besoj se dy objektivat kryesorë të kësaj reforme duhet të jenë minimizimi i kostove dhe maksimizimi i cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve. A mund ta kuantifikoni këtë realizim objektiv, pra sa janë reduktuar kostot në përfundim të 4-vjetarit që është zbatuar kjo reformë? Sa kemi përfituar financiarisht nga ana e kostove dhe si mund ta themi, apo si është matur perceptimi i qytetarit për shërbime më të mira sot? Do të doja të dija nëse keni një konkluzion tuajin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ishte i vetmi që bëri pak kritika, bëri ca dallgë të vogla, por në përgjithësi bashkëpunimi ishte optimal. Ju thatë që jeni dakord që në bashkitë e tjera përjashtoj Bashkinë e Tiranës, e cila

ka pasur një rritje edhe në buxhetin paraardhës, në mos gaboj 4 miliardë lekë të reja shtesë të të ardhurave, të cilat iu rishpërndanë, që do të thotë se ka pasur mundësi të realizojë edhe objektiva të tjera, ka pasur 3-4% rritje të të ardhurave në saj të reformës së suksesshme. Unë i kam parë konkretisht buxhetet vendore me shifra dhe ato i realizojnë të ardhurat e tyre në 30%, pra arrijnë të mbulojnë me të ardhurat e veta shpenzimet. 70% janë komplet të varur nga qeveria.

A i keni evidentuar shkaqet? Mua më bëri përshtypje ristrukturimi që thatë, pra që ka një fryrje, ka një mbingarkesë, ka kosto më të lartë të personelit që ka penalizuar investimet. Nëse kjo që ju evidentoni lidhet me 39 bashkitë e djathta, apo të gjitha bashkitë kanë struktura të mbingarkuara, duke pasur parasysh se kryetarët e bashkive kanë qenë të majtë. Kryetarët e kësaj qeverie kanë fryrë, por nuk besoj se do ta thoni këtë, se me siguri e keni evidentuar në bashkitë e djathta këtë fryrje strukture.

Nëse nuk ka dallime politike në struktura do të doja të dija cilat konstatoni që kanë rritje, sepse nëpër qytete mungon shumë cilësia e shërbimeve, nuk është ajo cilësi që është në Tiranë, e cila është vërtet një qytet i mirë. Në qytete të tjera nuk është gjithë kjo cilësi e lartë e shërbimeve që bashkia u ofron qytetarëve. Ku është ky numër i lartë i të punësuarve? Për shembull, Bashkia e Durrësit ka probleme në shërbimin e zyrës së taksave vendore, në menaxhim dhe ka nevojë për një program financiar digjital për të arritur një performancë më të mirë të mbledhjes së të ardhurave. Cila strukturë ju rezulton se ka fryrje? Pastro-gjelbërimi, apo arsimi parashkollor? Cilat janë pjesët e administratës bashkiake që janë të fryra dhe që ju kërkoni t'i rishikoni? Duhet pasur parasysh që këtu është ngritur disa herë shqetësimi i mungesës të personelit që asiston gratë e dhunuara, gratë në nevojë, apo shtresat në nevojë? Bashkitë kanë mungesë të personelit për problematika të veçanta. Ju thoni se ka fryrje diku tjetër.

Me sa kuptova borxhet e bashkisë kërkoni një amnisti. Në fakt, në buxhetin qeveritar bashkitë përbëjnë një prej debitorëve kryesorë, se nuk kanë likuiduar faturat për ujë, drita, etj. Tani nuk i kemi informacionet e detajuara, por dimë që bashkitë janë debitorë ndaj qeverisë. Nëse ju, kërkoni një amnisti, pra që qeveria të falë pjesën e detyrimeve që lidhen me investimet, nuk do të isha kundër, se bashkitë vazhdojnë të funksionojnë pa pritur fare që të shlyhen ato detyrime, pasi ia kanë lënë qeverisë atë faturë. Tani detyrimet do të jenë pak më të mëdha.

Lidhur me demokracinë vendore, për të cilën foli kryetari, që është shumë e rëndësishme (standard, objektiv, transparencë dhe pjesëmarrja e qytetarit), në këtë vit të ri, ku të gjitha bashkitë janë të një partie, pjesëmarrja qytetarë ka rënë, sepse ka rënë besueshmëria dhe ata nuk marrin pjesë në dëgjesa publike, se nuk besojnë se do të bëhet ndonjë gjë nga çfarë

mendojnë. Si do të përmirësohet pjesëmarrja e qytetare? Ju siguroj se kam qenë vetë në dëgjesat publike në Durrës dhe nuk janë më shumë se 5 apo 10 persona, sepse vjen vetëm administrata, qytetarët jo. Kështu që duhet bërë diçka që qytetarët të kenë më shumë besim dhe të marrin pjesë në dëgjesat publike, se nuk është ajo pjesëmarrje që publikohet *online*. Ju siguroj se pjesëmarrja në dëgjesat publike është shumë e ulët, të paktën në Durrës është pothuaj inekzistente, nuk e di në qytetet e tjera.

Kaq çështje kisha se nuk dua t'ju mërzis, por shpresoj që reforma e re territoriale të rezultojë një sukses nëpër bashki, që aty të jenë të gjitha forcat politike, këshillat bashkiakë të jenë më funksionale dhe shpresoj që zëri i gruas të jetë më i pranishëm, më konsistent dhe më cilësor.

Ju faleminderit!

**Bashkim Fino** – Ju thashë që në fillim që nënkomisioni ynë ka ekspertë që e njohin mirë fushën. Edlira ka qenë këshilltare të Bashkinë e Durrësit dhe e gjithë problematika që ngriti është në funksion të një njohjeje shumë të mirë të çështjeve në bashki. Diskutimi i saj ishte në vazhdim të diskutimit që bëra unë dhe të problemeve që thatë ju, jo më tepër për të marrë përgjigje, se ne kemi raportet përkatëse bashkë me të dhënat, sesa fakti që ne duhet t'ju monitorojmë më mirë në terren dhe kur të vijne aktet nënligjorë dhe ligjet ne do të marrim një vendim në mbledhjen e Këshillit Konsultativ.

Unë u mundova të bëja një përmbledhje të të gjitha çështjeve që trajtuam sot në këtë mbledhje. Edlira tha një mori gjërash të domosdoshme për pushtetin vendor, por sot kishim për të trajtuar plotësimin i kuadrit ligjor në funksion të decentralizimit dhe sidomos të ndarjes territoriale, strukturat e bashkive, Këshillin Konsultativ dhe, natyrisht, edhe analizën e decentralizimit, e cila është çështje shumë e gjerë, prandaj dhe Edlira u zgjat më shumë në këtë pikë, pasi është një pikë për të cilën mund të flasësh për orë të tëra, sepse kërkon një kohë më të gjatë. Ju ishit shumë të saktë, por na mirëkuptoni në zgjedhjen që bëmë, sepse ka gjëra për ta cilat duhet të mblidhemi më shpesh si komision.

Unë mund të ta jap fjalën për të thënë diçka, por do ta ndash mendjen: ose do të ma japësh si shoqëri civile, ose si opozitë. Po e the si opozitë do të ta jap menjëherë, po e the si shoqëri civile nuk ta jap fjalën.

**Agron Haxhillari** – E para, unë të falënderoj për ilaritetin, dua të bëj sot këtu një ofertë: nëse zonja deputete largohet që nga ky moment nga parlamenti, unë e marr në punë te Shoqata e Bashkive, se qenka shumë e mirë profesionalisht. E kuptoj që do të humbi shumë, por...

**Bashkim Fino** – Para se ta marrësh, do të marrësh leje nga kryetari.

Ke dy pengesa, një nga kryetari i grupit, Nimeti, dhe një nga nënkryetari i Nënkomisionit të Pushtetit Vendor, Bashkimi. Kjo ishte për pak humor.

Nëse nuk ka ndonjë gjë, le të përgatitemi të gjithë, të presim të na vijë edhe agjenda e mbledhjes së Këshillit Konsultativ! Unë dhe kolegët e mi jemi me këtë që dëgjuam dhe më këtë diskutim që bëme, domethënë duhet të merremi më shumë me pushtetin vendor. Do të jemi të pranishëm në atë mbledhje si vëzhgues dhe po të kemi ndonjë gjë do ta themi.

Vazhdojmë me Këshillin Konsultativ dhe le t'i lëmë kohë vetës të marrim vesh se çfarë vendimi do të merret atje për të bërë një takim të dytë për financat lokale, sidomos si i krijojnë ata të ardhurat, si dhe të na silltë një material i ndërgjegjësuar nga bashkitë dhe nga Ministria e Brendshme.

Besoj, kolegë, se jemi dakord me këtë konkluzion në mbyllje të mbledhjes së parë.

Falënderoj edhe njëherë zëvendësministren, Drejtorin e Përgjithshëm të agjencisë, të dy drejtorët ekzekutivë të shoqatave dhe , në mënyrë të veçantë, edhe kolegët e mi deputetë, që patën durimin t'ju dëgjonin juve dhe mua!

Ju falënderoj shumë për të gjithë këtë eksperiencë dhe mundësi që na dhatë!

Drejtori i agjencisë duhet të na paraqesë të gjitha dosjet, qoftë matricën, qoftë aktet ligjore e nënligjore për t'iu vënë në dispozicion anëtarëve të komisionit, që t'i kenë me vetë për t'i parë.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**